



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 59/ Prot.

Datë 26.11.2025

VENDIM

Nr. 1235, Datë 26.11.2025

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Korçë dhe gjëbëjtjen e ndërmarrjes Besim Thaqi PF për shkelje të konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 74, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin e thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar;
- Pretendimet/shpjegimet e dhëna nga ndërmarrja Besim Thaqi PF në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë AK-së më datë 06.10.2025;

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjatë vitit 2024 ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve për analizimin e kushteve të këtij tregu.

2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të këtij monitorimi, me Vendimin nr. 1085, datë 14.06.2024, "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta - perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë", vendosi hapjen e hetimit paraprak për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës".
3. Në vijim, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1114, datë 04.10.2024 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë", vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, për periudhën kohore nga 1 Janar 2023 deri në 30 Shtator 2024.
4. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të vendimit nr. 1114, datë 04.10.2024 të Komisionit të Konkurrencës, vendimit nr. 48(89-2025-213), datë 13.02.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Lushnjë "Për lëshimin e autorizimit Autoritetit të Konkurrencës për të kryer kontroll në ambientet e shoqërisë "Marshea" SH.P.K me NIPT K53915401R", bazuar në nenet 35, 36 dhe 37 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 27/143, datë 14.11.2024 "Autorizim inspektorësh", si dhe nr. 59/16, datë 20.03.2025 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit të thelluar proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, si dhe pranë shoqërisë së kontabilitetit Marshea SHPK.
5. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit të thelluar janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve, MZHBR, DPD, DPT, Drejtoritë Rajonale Tatimore Elbasan, Korçë, Fier si dhe INSTAT, si dhe janë marrë në konsideratë eksperiencia të ndryshme nga Autoritetet e Konkurrencës dhe Komisionit Europian. Për më tepër janë realizuar takime me Fermerët në terren si dhe në ambientet e Autoritetit. Gjithashtu janë marrë në analizë raporte dhe studime të ndryshme nga eksperiencia europiane dhe OECD.
6. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, në datat 06.10.2025 dhe 09.10.2025, zhvilloi seancat dëgjimore me përfaqësues të ndërmarrjeve: Omer Fruit SHPK, Nedrete Arapi PF, Besim Thaqi PF, Morina Grup SHPK, Agaçi Greens SHPK, Gazmir Kavaja PF, Rinaldi SHPK, Denis Manko PF, Zhaku Metushi PF, Fruit-To-Zela SHPK, Roland-2012 SHPK dhe Tiljano Asko PF, si dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Prapësimet e paraqitura nga ndërmarrjet nën hetim në seancë dëgjimore, si dhe të paraqitura me shkrim në vijim të kësaj seance, janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi.

II. RREGULLIMI LIGJOR I TREGUT

7. Tregu i prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve rregullohet nga ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar; ligji nr. 9817, datë 22.10. 2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.
8. Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, përben bazën kryesore ligjore për rregullimin e aspekteve më thelbësore sa i takon garantimit të cilësisë së ushqimit në vend. Referuar këtij ligji, ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në cilësinë e operatorëve të biznesit ushqimor, janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore në treg, si dhe duhet të përmbushin kërkesat për licencimin e stabilimenteve, import-eksportin, etiketimin, dhe standardet higjieno-sanitare. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Kriteret për pajisjet me licencë të veprimtarisë së grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve përcaktohen në VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, kriteret këto të cilat vlersohen të nevojshme për garantimin e cilësisë së produkteve ushqimore në vend, duke mos përbërë barrierë ligjore për hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg, në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
9. Në zbatim të ligjit nr. 9817, datë 22.10. 2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, fermerët individualë, grupet e fermerëve, personat fizikë, personat juridikë dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB) janë përfitues nga masat e mbështetjes dhe masat e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në rast aplikimi si grup fermerësh anëtarët e grupit duhet të nënshkruajnë Marrëveshje Tip dakordësie/bashkimi të fermerëve si edhe “Kontratën tip për shitjen e produktit” me një subjekt të licencuar grumbullues/përpunues të produktit. Këto marrëveshje/kontrata tip janë konsideruar të nevojshme për arritjen e objektivave të politikave bujqësore e të zhvillimit rural, si dhe nuk pëmbajnë dispozita kufizuese për konkurrencën sipas nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si: caktimin e çmimit të shitjes, apo kushte të tjera tregtimi.
10. Referuar ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në seksionin 4, të kreut XI, përcaktohet një regjim i veçantë për skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë. Në zbatim të këtij ligji Ministri i Financave ka miratuar Udhëzimin nr. 19, datë 03.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, i cili ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat mbi zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar për skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë/fermerëve. Në respektim të këtij Udhëzimi, ndërmarrjet që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve duhet të realizojnë blerjen e këtyre produkteve vetëm nga fermerë të pajisur me NUIS (numër unik i identifikimit të subjektit), sipas “Akt-marrveshjes “TIP” të lidhur me këta

fermerë. Lidhja e kësaj “Akt-marrveshjeje “TIP” në zbatim të regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar, ndihmon në formalizimin e tregut, por nuk sjellë asnjë lehtësim financiar për fermerët, pasi në zbatim të nenit 148 të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 0%.

11. Bazuar në shkresën e DPT nr. 27/89 prot., datë 30.09.2024, referuar nenit 7.3 të udhëzimit nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, në rastet e furnizimeve rastësore të marra nga individë të ndryshëm që nuk kanë cilësinë e tregtarit, përfshirë prodhuesit bujqësorë që nuk janë pjesë e skemës së kompensimit, tatimpaguesi (pra blerësi) lëshon një autofaturë pa llogaritur TVSH-në. Kjo faturë duhet të vërtetohet nga individ i furnizues nëpërmjet nënshkrimit dhe të dhënave të tjera identifikuese të tij si emër/mbiemër dhe numër personal identifikimi, të cilat duhet të regjistrohen në faturë. Tatimpaguesi, si marrës i furnizimit është i detyruar që të shënojë në faturën e përgatitur për veten e tij edhe NIPT-in e tij. Fatura e lëshuar nga blerësi, person i tatueshëm si subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin ose tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, është dokumenti që justifikon shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.
12. MBZHR në përgjigjen e saj (shkresa nr.27/10 prot.AK, datë 18.03.2024) shprehet se, aktet që rregullojnë tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve do të parashikohen të transpozohen dhe adoptohen pas hyrjes në fuqi të Rregullores së Bashkimit Evropian nr. 1308/2013 “Mbi organizimin e tregut të përbashët”. MZHBR, është anagazhuar të përafroj kuadrin ligjor Evropian të CAP gjatë screening the Grupkapitullit 5, dhe Kapitullit 11. Direktiva 2019/633 (UTP) “Mbi praktikat e padrejta tregtare në marrëdhëniet e biznesit në zinxhirin e furnizimit bujqësor dhe ushqimor” është një ndër aktet që do të përafrohet nga MZHBR gjatë vitit 2027 dhe do të fillojë zbatimin në 2029 në bashkëpunim me AK.
13. Sa më sipër, referuar legjislacionit vendas dhe atij evropian, rezulton se baza ligjore për tregun e prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve ka mungesa ligjore të akteve të BE për mirëfunksionimin e të gjitha niveleve të tregut.

III. NDËRMARRJET NËN HETIM

14. Referuar Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1114, datë 04.10.2024 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”, ndërmarrjet nën hetim janë:
 - Qarku Berat (8 ndërmarrje): Erdi I. Lundra SHPK, Oshafi 2011 SHPK, Tiljano Asko PF, Tomato – Al SHPK, Junil/B SHPK, Omer Friut SHPK, Livan Vrapit PF, Ledjan Cjapi PF.
 - Qarku Fier (23 ndërmarrje): Top Fruits SHPK (Doni Fruits), Erjoni–Agro SHPK, Morina Grup SHPK, Ardian Kuka PF, Rinaldi SHPK, Fraeno Agriculture SHPK, Nedrete Arapi PF, Dorjan Hazizi PF, Viktor Sakaj PF, Zhaku Metushi PF, Elkos

SHPK, Agaçi Greens SHPK, Roland-2012 SHPK, Denis Manko PF, Frutamina SHPK, L & B Fruits 2006 SHPK, Besim Thaqi PF, Agro Import Export Karaj SHPK, Agro Divjaka SHPK, Romir SHPK, Fruit-To-Zela SHPK, Gazmir Kavaja PF, Oksana Panina PF.

- Qarku Tiranë (10 ndërmarrje): Besim Allaraj PF, Kadiu-2005 SHPK, Mazniku Frut 15 SHPK, Mendor Çami PF, Geri SHPK, Alfred Dina PF, Bora Fruit SHPK, Fruit Co SHPK, Kei Fruit SHPK, Ryzhdi Gjokpali SHPK.
- Qarku Elbasan (1 ndërmarrje): Orion Moli PF.
- Qarku Korçë (5 ndërmarrje): Vasport SHPK, Theodhoraq Çipi PF, Kostandina Çipi PF, Jorgo Çipi PF, Blerim Becolli PF.

IV. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

15. Përcaktimi i tregut përkatës është elementi kryesor i analizës së konkurrencës. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, *“tregu përkatës përbëhet nga produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”*. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- a) Tregu përkatës i produktit;
- b) Tregu përkatës gjeografik.

16. Bazuar në vendimin e KK nr. 1114, datë 04.10.2024, “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”, tregu përkatës i produktit përfshin tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve për kulturat e perzgjedhura, perime si: qepë, preshe, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, karrota dhe specia; dhe fruta si: mollë, portokalle, limona, luleshtrydhe dhe dardha. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet qarku Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

III.2 Struktura e tregut

17. Nivelet e tregut janë Prodhuesit (fermerët), Grumbulluesit (të cilët operojnë si importues, eksportues, dhe shitës brenda vendit), shitësit me shumicë në tregjet agroushqimore dhe shitësit me pakicë.
18. Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 2023, u prodhuan 912.448 ton perime të njoma, duke shënuar rënie prej 0,27 %, krahasuar me një vit më parë. Në grupin e perimeve të njoma, kulturat përfaqësuese, janë domatja me 309.343 ton (33,90 %), kastraveci 128.845 ton (14,12 %) dhe speci 104.982 ton (11,51 %). Prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 22,43 % të prodhimit gjithsej të perimeve, nga ku 78,50 % e këtij prodhimi

i përket Qarkut Fier dhe Berat. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2022 dhe 2023, rezulton se qarqet më të mëdha për prodhimin e perimeve në serra janë qarku i Fierit, Beratit dhe Tiranës, ndërsa për prodhimin e frutave janë qarku i Korçës dhe Elbasanit. Këto janë qytetet të cilat kanë peshën më të madhe të prodhimit në vendin tonë.

19. Tregu i fruta-perimeve në 2023 mbulohet në mbi 95% nga prodhimi vendas, gjë që tregon fuqi të madhe të prodhuesve vendas, por edhe mundësi për përqendrim të tregut në disa duar nëse eksporti kontrollohet nga pak subjekte. Eksporti përfshin gati 12% të prodhimit total.
20. Nga të dhënat e DPD në lidhje me importet dhe eksportet e realizuara konstatohet se për vitin 2023, importet e fruta perimeve në vend zënë rreth 4% e sasisë totale të prodhuar, ndërsa eksporti i fruta perimeve është rreth 12% e sasisë totale të prodhuar brenda vendit për kulturat e marra në analizë, gjë që tregon se konsumi i fruta perimeve në tregun e brendshëm mund të mbulohet nga prodhimi brenda vendit.
21. Përcaktimi i ndërmarrjeve të marra në analizë është kryer bazuar në informacionin e dërguar nga: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë dhe Elbasan, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe nga inspektimet e realizuara, gjatë të cilave u konstatua se në treg operojnë një numër shumë i madh ndërmarrjesh, ku pjesa më e madhe e ndërmarrjeve janë persona fizik.
22. Sic u parashtrua edhe tek pjesa e kufizimit të analizës ku: Përcaktimi i ndërmarrjeve dhe identifikimi i pjesëve të tregut për secilën ndërmarrje në çdo hallkë të zinxhirit të vlerave, si dhe totali i këtij tregu është e vështirë për tu llogaritur pasi: *MZHBR nuk ka të dhëna sasiore dhe as një regjistër specifik për fermerët, grumbulluesit dhe tregtuesit me shumicë të fruta perimeve.* Të dhënat e DPT të vëna në dispozicion, janë lista subjektesh (97 ndërmarrje) pa të dhëna sasiore, dhe identifikimi i subjekteve është realizuar pas nxjerrjes së xhiros nga ekstraktet e pasqyrave financiare në QKB për vitin 2022, pasi për vitin 2023 nuk është realizuar akoma dorëzimi i pasqyrave financiare nga ana e ndërmarrjeve. Gjatë kërkimit kanë rezultuar raste të ndërmarrjeve të cilat kanë nisur aktivitetin gjatë vitit 2023, por për të cilat nuk ka të dhëna sasiore në QKB, raste kur ndërmarrjet kanë kaluar në status pasiv, raste kur kanë kaluar në masën sekuestro me vendim gjykate dhe raste kur ndërmarrjet nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare gjatë vitit 2022, ndaj dhe këto ndërmarrje nuk janë përfshirë në analizat e mëposhtme. Gjithashtu është vërejtur që nga ndërmarrjet vëna në dispozicion nga DPT ishin të përfshira edhe ndërmarrjet të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e grumbullimit të bimëve medicinale, pambukut, duhanit etj., pra ndërmarrje që nuk ushtronin veprimtari me xhiro specifike në tregun e grumbullimit të fruta perimeve. *Informalitet i lartë:* Ndonëse bujqësia zë më shumë se 20% të GDP¹, një pjesë shumë e madhe e fruta-perimeve të freskëta shiten informalisht². DPD ka dërguar të dhëna mbi importet dhe eksportet e vitit 2023 dhe janar – mars 2024 ku janë identifikuar ndërmarrjet importuese dhe eksportuese.

¹ https://aida.gov.al/ep-content/uploads/2024/01/fruta_dhe_perime_.pdf

² <https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/UNIDO%20GQSP%20ALBANIA%20Fruits%20%20Vegetables%20Value%20Chain%20STUDY%202023.pdf>

23. Sipas të gjithë të dhënave të mësipërme të cilat u kryqëzuan, u për zgjodhën ndërmarrjet të cilat kishin një xhiro në treg mbi 2% ndaj totalit. Gjithashtu nga të dhënat e Tatimeve ndërmarrjet e marra në analizë zënë pjesën më të madhe në qarkun përkatës.

III.3 Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve

24. Analiza e sjelljes është realizuar për të parë nëse ka sjellje të bashkërenduara në shkelje të nenit 4 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese për koordinimin dhe diktimin e çmimeve të blerjes tek fermerët.
25. Çmimet e diktuar nga grumbulluesit i detyrojnë fermerët të shesin produktet e tyre tek disa grumbullues të mëdhenj të zonës gjeografike (afërsisë me fermeret), të cilët kontrollojnë një pjesë të madhe të tregut. Kjo krijon varësi të madhe nga një ose disa grumbullues dhe nuk i lejon fermerët të kenë mundësi zgjedhje për grumbullues të tjere alternative. Kjo mund të bëjë që ata të jenë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të çmimeve të diktuar nga grumbulluesit.
26. Çmimet e ulëta të blerjes të imponuara nga grumbulluesit kanë pasoja të shumta dhe të dëmshme për fermerët, duke e vështirësuar mbijetesën e tyre ekonomike dhe duke krijuar një mjedis të pasigurt për zhvillimin e sektorit bujqësor.
27. Nga inspektimet u konstatua se:
- Më datë 26.03.2025, u krye inspektim në ambientet e ndërmarrjes Marshea SHPK, me NIPT K53915401R, që ushtron aktivitet si i ngarkuar me menaxhimin kontabël të ndërmarrjeve grumbulluese nën hetim, me adresë: L. Kadri Qystri, Rr. Fan Noli, Lushnjë. Gjatë inspektimit u mbajt Procesverbal i datës 26.03.2025, “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit” me përfaqësuesin e ndërmarrjes z. Eduart Sharka, si dhe Procesverbal i datës 26.03.2025, “Mbi inspektimin në ndërmarrje”.
 - Pranë ndërmarrjes Marshea SHPK nga Grupi Inspektimit, përveç të tjerash, u gjetën evidenca (lista) të vonesave në detyrimet kontraktuale dhe tregtare (debi), për detyrimet e pa paguara ndaj fermerëve për vitet 2022-2024 (të kategorizuara në Banka dhe cash), nga rreth 13 ndërmarrje grumbulluese që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarqet Berat, Lushnje dhe Fier, konkretisht: Frutamina SHPK, Nedrete Arapi PF, Orion Moli PF, Omer Fruit SHPK, Roland-2012 SHPK, Erjoni-Agro SHPK, Morina Grup SHPK, Livan Vrapi PF, Agro Import Export Karaj SHPK, Ardian Kuka PF, Agro Divjaka SHPK, Junil/B SHPK, Besim Thaqi PF. *Kjo problematikë e evidentuar sic u sqarua, mund të gjente rregullim nga direktiva 2019/633 (UTP). Direktiva 2019/633 (UTP) “Mbi praktikat e padrejta tregtare në marrëdhëniet e biznesit në zinxhirin e furnizimit bujqësor dhe ushqimor” është një ndër aktet do të përafrohet nga MZHBR gjatë vitit 2027 dhe do të fillojë zbatimin në 2029 në bashkëpunim me AK.*
 - Konkretisht marrdheniet kontraktore (kreditor-debitor) në tregje rregullohen nga ligji nr. 48/2014 “Për vonesat në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, i ndryshuar, që përcakton rregullat për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e

ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, ky ligj rregullon edhe çështjet e vonesave të pagesave që rrjedhin nga transaksionet tregtare ndërmjet prodhuesve bujqësorë dhe sipërmarrjeve tregtare që grumbullojnë, përpunojnë, eksportojnë produkte bujqësore, por në praktikë nuk zgjidh problematikat që dalin në dinamikën e këtij tregu rast pas rasti.

- Në zbatim të nenit 8, pika 4, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 19, datë 03.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, disa prej ndërmarrjeve grumbulluese të fruta-perimeve lidhin Akt-marrëveshje “TIP” për blerjen e fruta-perimeve me fermerë të pajisur me NUIS.
 - Këto Akt-marrëveshje TIP kanë për objekt furnizimin me produkte bujqësore nga fermeri furnizues i produkteve, për personin e tatueshëm blerës të këtyre produkteve, i cili garanton se në momentin e disponimit të produkteve bujqësore do të pajisë fermerin me faturë tatimore me TVSH të plotësuar në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Në akt-marrëveshje nuk përcaktohet mënyra e furnizimit të fruta-perimeve, por nga takimet me fermerët dhe inspektimet e realizuara pranë ndërmarrjeve nën hetim, ka rezultuar se kryesisht janë ndërmarrjet grumbulluese ato që kryejnë transportin e fruta perimeve nga fermeri në magazinat e tyre.
 - Gjate inspektimeve të zhvilluara dhe informacioneve të kërkuar në mënyrë shkresore në ndërmarrjet objekt hetimi është kërkuar të evidentohen edhe fermeret me të cilat këto ndërmarrje bashkëpunonin në marrjen e produkteve.
 - Referuar nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: *“Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150 000 lekë”*.
 - Gjatë periudhës hetimore konkretisht në inspektimet e kryera dhe në informacionet e administruara nga ndërmarrjet të cilat janë objekt hetimi u konkludua se ndërmarrjet kryenin pagesa cash dhe pagesa me bankë ndaj fermerëve apo edhe ndërmarrjeve për mallrat të cilat ata blinin. Nga statementet bankare të vendosura në dispozicion nga disa ndërmarrje të cilat përdornin këtë sistem pagesash u pa lidhja midis pagesës me bankë dhe faturës përkatëse me nr dhe datë në varësi të blerjeve të kryera. U vu re se pagesat e realizuara në bankë nuk kanë informacion në lidhje me sasinë apo çmimin për fermeret por vetëm vlerë në lek/euro. Gjithashtu në raste të tjera u administruan modele pagesash me cash duke u vënë në dispozicion nga ndërmarrjet mandate pagesash për blerjen e mallrave tek fermerët. Sipas deklarimeve gjatë inspektimeve pagesat me cash bëheshin për arsye të ndryshme por mbizotëronin arsyet e mos regjistrimit të fermerëve dhe mos pasja e llogarive bankare nga shumë prej tyre.
28. Nga analizimi i të dhënave të elementeve që ndikojnë në formimin e çmimit të shitjes të dërguara nga ndërmarrjet nën hetim vërehet se, zërat e kostos së ndërmarrjeve grumbulluese të cilat eksportojnë në vende të ndryshme sipas kontratave me klientët përkatës produktet e tyre përbëhen kryesisht nga:
- Kosto e blerjes së produktit nga fermerët e cila zë rreth 85% të pjesës së kostos;
 - Kosto e ambalazhimit me arka, qese plastike, paleta etj që zë rreth 10% të pjesës së kostos;

- Kosto operative ku perfshihet transporti, kosto punes etj e cila zë rreth 5% të pjesës së koston.
29. Referuar grumbulluesve të cilët blejnë tek fermerët dhe shesin brenda vendit, çmimi i blerjes nga fermerët zë pjesën më të madhe të koston me rreth 92% dhe elementi tjetër është transporti i cili realizohet në tregjet e qarkut. Përsa i përket koston së grumbulluesve të cilët importojnë fruta perime, zërat që përbëjnë koston së produktit janë çmimi i blerjes jashtë vendit, transporti dhe dogana. Pra nga sa vërehet elementi kryesor i formimit të koston së produktit fruta-perime është çmimi i blerjes tek fermerët apo në tregjet e huaja.
 30. Analiza e realizuar në lidhje me çmimet e blerjes/grumbullimit lidhet me rastet kur ndërmarrjet nën hetim kanë pasur çmime mesatare mujore të blerjes/grumbullimit të përafërta me diferenca nga 0 deri në 2 lek/kg. Analiza është kryer për perimet dhe frutat më sasisht më të mëdha të grumbulluara përkatësisht për kastravec, specin, domaten, presh, luleshtydhe, patate, qepë dhe lakër. Analiza e çmimeve mesatare mujore të blerjes është kryer për periudhat ku secili produkt ka sezonin e tij prodhimit dhe të grumbullimit, pra periudhat mujore kur ndërmarrjet grumbulluese kanë kryer sasinë më të madhe të grumbullimit për produktet përkatëse. Në vijim kjo analizë është realizuar për ndërmarrjet që kanë studio kontabël "Marshea" SHPK, si dhe sipas qarqeve të marrë në analizë (Berat, Fier, Elbasan, Tiranë dhe Korçë). Kjo analizë shoqëruar edhe me analizën e mark – up për çmimet e shitjes (eksport Berat dhe Fier; brenda vendit Tirane dhe Korçë), do të paraqesi një pamje më të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve.
 31. Nga analiza e çmimeve mujore të blerjes nga fermerët për produktin e kastravecit rezulton se ndërmarrjet me çmime mesatare të përafërta me një diferencë shumë të vogël (-/+2 lekë/kg) për vitin 2023 janë: në muajin mars 2023, ndërmarrjet Morina Grup SHPK dhe Besim Thaqi PF me çmime mesatare mujore përkatësisht 1.50 lekë/kg dhe 1.50 lekë/kg, ndërmarrjet Fruit-To-Zela SHPK dhe Roland-2012 SHPK janë përkatësisht me 1.50 lekë/kg dhe 1.50 lekë/kg, në muajin tetor 2023, vërehet se për ndërmarrjet Besim Thaqi PF dhe Fruit-To-Zela SHPK çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht 1.50 lekë/kg dhe 1.50 lekë/kg. Për muajin prill 2024, për ndërmarrjet Nedrete Arapi PF, Fruit to Zela SHPK, Roland-2012 SHPK janë përkatësisht 1.50 lekë/kg, 1.50 lekë/kg, 1.50 lekë/kg.
 32. Për vitin 2024, nga analiza e çmimeve mujore të blerjes nga fermerët për produktin e kastravecit, vërehet se ndërmarrjet Roland-2012 SHPK dhe Besim Thaqi PF kanë çmime mesatare mujore përkatësisht 1.50 lekë/kg dhe 1.50 lekë/kg, për ndërmarrjet Fruit-To-Zela SHPK, Nedrete Arapi PF janë përkatësisht 1.50 lekë/kg, 1.50 lekë/kg.
 33. Nga analiza e çmimeve mujore të blerjes nga fermerët për produktin e domates rezulton se për vitin 2023, në muajin tetor 2023 çmimet mesatare mujore të ndërmarrjeve Omer Fruit SHPK dhe Roland-2012 SHPK janë 1.50 lekë/kg dhe 1.50 lekë/kg. Për vitin 2024, në muajin prill 2024 ndërmarrjet Morina Grup SHPK dhe Roland-2012 SHPK, kanë rezultuar me çmime mesatare mujore mujore të blerjes përkatësisht 1.50 lekë/kg dhe 1.50 lekë/kg.
 34. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të blerjes nga fermerët për produktin e specit për vitin 2023, konkretisht në muajin prill 2023, vërehet se për ndërmarrjet Morina

- Grup SHPK dhe Besim Thaqi PF kanë çmime mesatare mujore të blerjes përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Për ndërmarrjet Besim Thaqi PF dhe Nedrete Arapi PF janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Në muajin korrik 2023, vërehet se për ndërmarrjet Roland-2012 SHPK dhe Omer Fruit SHPK çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Për ndërmarrjet Nedrete Arapi PF dhe Besim Thaqi PF janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Në muajin shtator 2023, vërehet se për ndërmarrjet Roland-2012 SHPK dhe Morina Grup SHPK çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg lekë/kg, për ndërmarrjet Omer Fruit SHPK dhe Besim Thaqi PF janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg.
35. Në muajin nëntor 2023 ndërmarrjet Nedrete Arapi PF, Besim Thaqi PF kanë aplikuar çmime mesatare mujore të blerjes nga fermerët çmimet përkatësisht lekë/kg, lekë/kg, në muajon prill për ndërmarrjet Nedrete Arapi PF dhe Omer Fruit SHPK çmimet mesatare mujore janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg.
36. Për vitin 2024, çmimet mesatare mujore të blerjes së produktit spec, konkretisht në muajin korrik 2024, për ndërmarrjet Orion Moli PF, Omer Fruit SHPK dhe Besim Thaqi PF çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg, lekë/kg dhe lekë/kg. Në muajin shtator 2024. Për ndërmarrjet Fruit-To-Zela SHPK dhe Nedrete Arapi PF janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg.
37. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të blerjes nga fermerët për produktin e preshit për vitin 2023 konkretisht në muajin janar ndërmarrjet Morina Grup SHPK dhe Besim Thaqi PF kanë aplikuar çmime mesatare mujore blerje përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Për ndërmarrjet Morina Grup SHPK dhe Besim Thaqi PF janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg.
38. Për vitin 2024, konkretisht në muajin mars 2024, vërehet se për ndërmarrjet Omer Fruit SHPK dhe Roland-2012 SHPK kanë aplikuar çmime mesatare mujore të blerjes përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Në muajin prill 2024, vërehet se për ndërmarrjet Roland-2012 SHPK dhe Fruit-To-Zela SHPK çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Për ndërmarrjet Omer Fruit SHPK dhe Nedrete Arapi PF janë përkatësisht lekë/kg lekë/kg.
39. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të blerjes nga fermerët për produktin e patates ndërmarrjet që kanë një diferencë të çmimeve mesatare mujore (-/+2 lekë/kg) janë si më poshtë: Në muajin Janar 2023, vërehet se për ndërmarrjet Morina Grup SHPK, Omer Fruit SHPK, Roland-2012 SHPK çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg, lekë/kg dhe lekë/kg ndërsa për ndërmarrjet Fruit-To-Zela SHPK dhe Besim Thaqi PF janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg.
40. Në muajin Maj 2024, vërehet se për ndërmarrjet Omer Fruit SHPK dhe Besim Thaqi PF çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Ndërmarrjet Besim Thaqi PF dhe Morina Grup SHPK kanë çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Në muajin qershor 2024, vërehet se për ndërmarrjet Morina Grup SHPK dhe Besim Thaqi PF kanë aplikuar çmime mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg.
41. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të blerjes nga fermerët për produktin e lakrës për vitin 2023, konkretisht në muajin janar vërehet ndërmarrjet Fruit-To-Zela SHPK dhe Morina Grup SHPK kanë aplikuar çmimet mesatare mujore të blerjes janë

përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Në muajin shkurt 2023, vërehet se për ndërmarrjet Besim Thaqi PF dhe Omer Fruit SHPK çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Për ndërmarrjet Fruit-To-Zela SHPK dhe Besim Thaqi PF çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg. Në muajin prill 2024, vërehet se për ndërmarrjet Omer Fruit SHPK dhe Roland-2012 SHPK çmimet mesatare mujore të blerjes janë përkatësisht lekë/kg dhe lekë/kg.

42. Në përfundim, nga analiza e çmimeve mesatare mujore të blerjes për të gjithë produktet dhe për të dy vitet e hetuara (2023–2024), rezulton se ndërmarrjet kanë aplikuar në mënyrë të përsëritur çmime pothuajse identike (-/+ 2 lekë/kg) në periudha të ndryshme prodhimi, në tregje të ndryshme produktesh (kastravec, domate, spec, presh, patate, lakër). Përsëritja e vazhdueshme e këtyre diferencave minimale ndërmjet të njëjtave ndërmarrje, në muaj të ndryshëm dhe për produkte të ndryshëm, e cila nuk është karakteristike për tregje të fragmentuara me variacione të mëdha sezonale, përbën një model të qëndrueshëm dhe të pashpjegueshëm ekonomikisht nëse nuk do të kishte një koordinim mes ndërmarrjeve.
43. Nga analiza e çmimeve të shitjes të aplikuara nga ndërmarrjet rezulton se: ndërmarrjet grumbulluese aplikojnë markup mbi 40% për kultura të ndryshme objekt i këtij hetimi, konkretisht:
 - Për ndërmarrjet pjesë e Marshea SHPK konkretisht Omer Fruit SHPK aplikon mark up maksimal për vitin 2023 deri në 115% dhe për periudhën Janar-Shtator 2024 deri në 110%; Nedrete Arapi PF aplikon mark up maksimal për vitin 2023 deri në 72 % dhe për periudhën Janar-Shtator 2024 deri në 91%; Besim Thaqi PF aplikon mark up maksimal për vitin 2023 deri në 103% dhe për periudhën Janar-Shtator 2024 deri në 54%, Roland-2012 SHPK aplikon mark up maksimal për vitin 2023 deri në 47%; Fruit-To-Zela SHPK aplikon mark up maksimal për vitin 2023 deri në 160% dhe për periudhën Janar-Shtator 2024 deri në 78% dhe Morina Grup SHPK aplikon mark up maksimal deri në 30%.
44. Pikërisht për këto ndërmarrje pjesë e studios kontabël “Marshea”Shpk, duke shtuar dhe çmimet e përafërta të blerjes/grumbullimit dhe aplikimi i mark-up-eve të ngjashme, të cilat, të marra së bashku, plotësojnë standardin e provës së mjaftueshme për të konstatuar sjellje të bashkërenduar sipas nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.
45. Ky standard vlerësimi mbështetet në parimin se rrethanat e jashtme të tregut, si ndërthurja administrative dhe qasja e përbashkët në informacione sensitive mund të krijojnë një mjedis të favorshëm për bashkërendim të ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve (“facilitating practices”).
46. Në jurisprudencën e BE dhe të disa autoriteteve kombëtare të konkurrencës, ekzistenca e një (platforme të përbashkët)³ konkretisht studio kontabel të përbashkët ku administrohen të dhëna të ndjeshme tregtare të tilla si çmimet e blerjes, volumni i furnizimeve dhe kushtet e pagesave, të cilat në vetvete përbëjnë indicie objektive të mundshme për koordinim të çmimeve përbën një element objektiv që rrit ndjeshëm

³ https://fra.europa.eu/en/caselaë-reference/cjeu-c-19414-p-judgment?utm_source=chatgpt.com

mundësitë për koordinim të sjelljes ndërmjet ndërmarrjeve, madje edhe kur mungon prova direkte e një komunikimi të shprehur.

47. Me ane të pasqyrave të marra është realizuar analizimi i të dhënave financiare për të gjitha ndërmarrjet duke evidentuar treguesit financiarë si: fitimi neto, të ardhurat e realizuara nga ndërmarrjet dhe norma e fitimit për secilen nga ato. Në vitin 2023, ndërmarrja Omer Fruit SHPK ka realizuar të ardhura _____, ndërmarrja Morina Grup SHPK, ka realizuar të ardhura _____. Ndërmarrja Fruit-To-Zela SHPK ka realizuar të ardhura _____ lekë, ndërmarrja Nedrete Arapi PF ka realizuar të ardhura _____ lekë. Roland 2012 SHPK ka realizuar të ardhura _____ dhe ndërmarrja Besim Thaqi PF me të ardhura _____ lekë.
48. Nga analiza e mësipërme rezulton se: ndërmarrjet Omer Fruit SHPK, Nedrete Arapi PF, Besim Thaqi PF, Morina Grup SHPK, Fruit-To-Zela SHPK, Roland-2012 SHPK, periodikisht nëpër periudhë sezoni, kanë caktuar çmimet e blerjes/grumbullimit, duke koordinuar dhe diktuar çmimet, si dhe aplikojnë mark-up shumë të larta (deri në 115%), duke përdorur fuqinë negociuese në përcaktimin e çmimeve të blerjes kundrejt fermerëve, si rrjedhim kjo sjellje e bashkërenduar e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, që caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e blerjes të produkteve nga fermerët, në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4, pika 1, gërma a) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, përbën një marrëveshje të ndaluar, shkelje e cila në bazë të nenit 74, vlerësohet si shkelje e rëndë e ligjit dhe vendoset gjobë nga Komisioni i Konkurrencës në masën deri 10% të xhiros së vitit financiar paraardhës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 4, nenin 24 shkronja d), nenin 26, nenin 43, pika 5, nenin 45, pika 1, nenin 74, pika 1, gërma a) dhe nenin 75, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.
- II. Gjositjen e ndërmarrjes Besim Thaqi PF, me numer NUIS L84519402Q për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 4, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0.15 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 237,911 Lekë (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë).
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Besim Thaqi PF për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përditësuara të produkteve që grumbullon.
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Besim Thaqi PF, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

- V. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA

()
Zn/Kryetar


Rezana KONOMI

()
Anëtar

Fatjola DELIJA

()
Anëtar

Durim KRAJA

()
Anëtar

Denar BIBA

()
Kryetar

